



| | |
|--|----------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE | |
| DRZAVNA AGJENCIA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA | |
| NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA | |
| ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE | |
| Njësi Org. Org. Jedn. Org. Unit | 01 |
| Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No. | 238 |
| Nr. i faqeve Istej stranica No. pages: | 02 |
| Data Datum Date: | 12 / 11 / 2013 |
| PRISHTINEJA | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agjencia za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr.02/15

Datë:22.10.2013

Në mbështetje të nenit 30 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr.20/2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 22.10.2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet procedura e transferimit të të dhënave personale nga BZMF te FINCA Kosovë.
2. BZMF – FINCA duhet të sigurojë që përmbajtja e katalogut të sistemit të dosjeve të jetë e saktë dhe të mbahet e përditësuar
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimiit.

Arsyetim

Me datë 30.08.2013 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia) ka pranuar një kërkesë nga World Relief BZMF (Besëlidhja/Zavet Mikrofinance) për aprovimin e procedurës së transferim të të dhënave personale nga BZMF te FINCA Kosovë.

Bazuar në kërkesën e BZMF – FINCA më datë 21.10.2013 Mbikëqyrësi shtetëror z. Aleksandar Spasić më datë 21.10.2013 ka realizuar një kontroll të jashtëzakonshëm në FINCA Kosovë për lëndën: Kontrollim i dosjeve për transfer në mes të BZMF dhe FINCA për të vërtetuar gjendjen faktike.

I pranishëm në kontroll nga BZMF-FINCA Kosovë ka qenë zyrtari i mbrojtjes i të dhënave personale z. Agron Berisha.

Në bazë të kontrollit u konstatua kjo gjendje :

Dokumentacioni i kontratës për transfer në mes të Word Relief dhe Finca si marrëveshje mbi dhurimin e pasurisë. Dosjet e klientëve të BZMF-së gjenden në ambient të veçantë që është i mbyllur me çelës dhe të njëjtat janë në ormana të metalt të ndara sipas Degëve/Qyteteve.

Dhe pritet të lejoj nga ASHMDHP-ja për ndarjen nëpër degë të këtyre dosjeve.

Qasje në këto dosje ka vetëm një person dhe ai është z. Agim Ferati - Projekt Menaxher. Procesverbali u nënshkrua nga z. Agron Berisha, z. Agim Ferati nga BZMF dhe FINCA Kosovë, dhe nga Mbikëqyrësi Shtetëror z. Aleksandar Spasić.

Në mbështetje të nenit 30, të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) të Rregullores së Punës Nr. 20/2011, dhe bazuar në procesverbalin e kontrollit, dokumentacionin e ofruar nga BZMF dhe FINCA Kosovë, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur me datë 22.10.2013, aprovon procedurën e transferimit të të dhënave personale nga BZMF te FINCA Kosovë.

Ruzhdi JASHARI


Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

Vendimi i dërgohet:

- FINCA - Kosovë
- Anëtarëve të Këshillit
- Arkivit të Agjencisë